REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
T I R A N Ë

Nr. 122 Regj. Themeltar **Nr. 162 Vendimi**
Dt. 24.06.2014 **Dt. 02.10.2014**

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Apelit Tiranë e përbërë nga gjyqtarët:

KRYESUES: GRAMOZ LEVANAJ
ANETAR: EDMOND GOGO
ANETARE: FATMIRA HAJDARI

Asistuar nga sekretare ***Dafina Morina***, sot me datën 02.10.2014 shqyrtoi çeshtjen civile qe u perket paleve ne gjykim:

KERKUES : S4E Grup GmHB, perfaqesuar nga Av.Gerhard Velaj.

PERSON I TRETE : Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, perfaqesuar nga Dritan Cela me autorizim.
Avokatura e Shtetit : Perfaqesuar nga avokate e shtetit Brunilda Lilo.

OBJEKTI : Njohja e vendimit perfundimtar te Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit, date 16.12.2008 dhe te shtojces se tij, date 10.04.2009 per ceshtjen gjyqesore civile me pale paditese S4E GmBH, i paditur Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) me Objekt detyrimin e te padituri te anulloje aktin e terheqjes se garancise bankare nr.8813G0607639 date 28.06.2006, leshuar nga banka Austriake Creditanstalt AG.Detyrimin e te padituri ti paguaj paditesit Shpenzimet ligjore qe lidhen me procesin gjyqesor te zhvilluar ne Gjykaten e Shkalles pare Vjene dhe ate te Arbitrazhit.

BAZA LIGJORE : Nenet 393, 395, 396, 397dhe 399 te Kodit te Procedures Civile.

Gjykata, mbasi shqyrtoi ceshtjen, mori provat e nevojshme gjate gjykimit, degjoi kerkuesin i cili kerkoi pranimin e kerkeses, Personin e trete i cili kerkoi rrezimin e kerkeses, avokaten e shtetit e cila kerkoi rrezimin e kerkeses, pasi degjoi relatorin Gramoz Levanaj e shqyrtoi eshtjen ne themel,

V E R E N

Ne kerkesen drejtuar gjykates kerkuesi S4E Grup GmbH ka kerkuar qe vendimit perfundimtar te Arbitrazhit Nderkombetar t'i jepet fuqi ligjore sipas legjislacionit te shtetit shqiptar, ne perputhje me nenet 395, 396, 397 e 398 te Kodit te Procedures Civile.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin Nr.114, dt.13.11.2009 ka vendosur si vijon :

Te njohe dhe jape fuqi per zbatim ne Republiken e Shqiperise vendimit nr. 14939 te Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar Paris France per te gjitha detyrimet e percaktuara ne ate vendim te paleve ne proces.

Mbi rekursin e ushtruar nga Avokatura e Pergjithshme e Shtetit, ceshtja eshte shqyrtuar nga ***Gjykata e Larte*** *e cila me vendimin* ***Nr.175, dt.24.04.2014*** *ka vendosur :*

Prishjen e vendimit nr.114, dt.13.11.2009 te Gjykates se Apelit Tirane dhe kthimin e ceshtjes per rishqyrtim po asaj gjykate, me tjeter trup gjykues.

Mbi detyrat e lena nga Gjykata e Larte ne vendimin e saj, Gjykata e Apelit Tirane riceli hetimin gjyqesor dhe administroi si prova Kontraten No.Ref.01-06/AJ-OST Maj 2006 e pekthyer dhe e noterizuar, si dhe Arbitazhin ICC Nr.14939/JHN ceshtje midis Ostelektra GMBH Gjermani dhe KESH sh.a Shqiperi e perkthyer dhe e noterizuar.

Nga hetimi gjyqesor rezultoi e provuar se ;

Kerkuesi S4E Group GMBH eshte nje shoqeri Gjermane e perfshire ne tregtine nderkombetare te energjise me shtetet e Europes. Me pare kjo shoqeri eshte njohur me emrin (OstElektra GmbH). Personi i trete Korporata Elektro Energjitike Shqiptare (KESH) eshte shoqeri Shqiptare me kapital shteteror perfshire ne prodhimin,shperndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike. Ne daten 29 maj 2006 palet ndergjyqese kane neshkruar kontraten midis tyre per

blerjen dhe shperndarjen e energjise elektrike per periudhen 1 korrik 2006 deri ne date 31 dhjetor 2006. Per tu garantuar furnizimi me energji elektrike kerkuesi ka paisur personin e trete me garancine bankare nr.8813G0607639, date 28 qershor 2006, leshuar nga banka Austriake Creditanstalt AG. Personi i trete Korporata Elektroenergjitike Shqiptare ka pretenduar se kerkuesi ka deshtuar ne furnizimin me energji elektrike sipas kushteve te kontrates,ndaj dhe ka tentuar te terheqe garancine bankare.

Mbi kerkesen e kerkuesit S4E Group GMBH eshte investuar Gjykata e Shkalles se pare Vjene dhe me date 25 janar 2007 ka leshuar urdherin per te parandaluar lirimin e garancise bankare. Gjithashtu po mbi kerkesen e kerkuesit eshte investuar arbitrazhi Nderkombetar i Dhomes se Tregtise Paris dhe kjo Gjykate Arbitrazhi ka vendosur;

-KESH nuk justifikohet te terheqe garancite bankare nr. 8813G0607639, date 3 korrik 2006 leshuar nga banka Austriake Creditanstalt AG.

-KESH urdherohet te anulloje terheqjen e kesaj garancie bankare.

-KESH duhet ti paguaj S4E Group shumen ne vleren 9.017,36 Euro qe i perket shpenzimeve qe lidhen me procesin gjyqesor ne Gjykaten e Shkalles se Pare Viene.

-Shpenzimet e Arbitrazhit te percaktuara nga Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit jane vlersuar ne shumen 290.000 00 Euro.

KESH duhet t'i kompensoje S4E Group 25% te ketyre shpenzimeve ne shumen 72.500,00 USD dhe shumen 6.631,20 USD persa i perket mbulimit te vleres se TVSH-se mbi shumen e mesiperme.

-KESH duhet te rimbursoje S4E Group ne masen 25% te shpenzimeve te arsyeshme ligjore dhe shpenzimeve te tjera te arsyeshme ligjore dhe te shpenzimeve te tjera te shkaktuara nga S4E Group ne kete arbitrazh ne masen 93.215,45 Euro

-Kunderpadite e KESH dhe te gjitha pretendimet e tjera nuk pranohen.

Personi i trete KESH ka kerkuar nga Gjykata e Arbitrazhit korrigjim dhe interpretim te vendimit dhe kjo e fundit ne shtojcen e vendimit ka vendosur ne lidhje me korrigjimin, por ka rrezuar kerkesen e interpretimit duke e konsideruar se kjo kerkese perben objekt te rishikimit te vendimit ne themel te tij. Avokatja e shtetit ne senace gjyqesore ka kerkuar nga pala e trete qe perkthimi te kryehej nga perkthyes te licensuar nga Ministria e Drejtesise, kerkese kjo e pranuar dhe e plotesuar nga personi i trete ne proces.

Ndersa ne seance te fundit avoktja e shtetit kerkoi qe ti kerkohet Gjykates se Arbitrazhit procesverbali i seances gjyqesore.

Nga ana e gjykates cmohet se kerkesa e kerkuesit eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

-Ligji i Zbatueshem.

Qe t'i jepet fuqi ketij vendimi te datave 16.12.2008 dhe 10 04 2009 te Arbitrazhit Nderkombetar,Gjykata e Apelit Tirane,ne respektim te nemt 397 te Kodit Procedures Civile nuk mund te shqyrtoje ceshtjen ne themel,por vetem kontrollon nese vendimi ne datat e mesiperme i dhene nga ai organ,eshte ose jo rezultat i nje procesi te rregullt ligjor, si dhe permban urdherime qe vijne ne kundershtim me nenet 393-399 te Kodit te Procedures Civile.

"Vendimit te nje gjykate ose te nje arbitrazi te huaj nuk i jepet fuqi ne Republiken e Shqiperise ne kuptimin e nenit 394 te Kodit Procedures Civile kur"

***a**-Sipas dispozitave qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, marreveshja nuk mund te jete kompetence te gjykates se Shtetit qe ka dhene vendimi.*

***b**-Kerkese padia dhe leterthirrja per ne gjyq nuk i eshte njoftuar te padituri ne mungese ne menyre te rregullt e ne kohe per ti dhene mundesi qe te mbrohet.*

***c**-Midis atyre paleve, per te njejtin objekt e per te njejtin shkak eshte dhene nje vendim i ndryshim nga gjykata Shqiptare. c-Eshte duke u shqyrtuar nga gjykata Shqiptare nje padi qe eshte ngritur perpara se vendimi i Gjykates se shtetit te huaj te kete marre forme te prere. . .*

***d**-I eshte dhene forma e prere ne kundershtim me legjislacionin Shqiptar.*

***dh**-Nuk pajtohet me parimet baze te legjislacionit Shqiptar.*

Ndersa ne nenin 396 te K.Pr.Civile parashikohet;

"Kerkeses per t'i dhene fuqi vendimit te gjykates se huaj duhet ti bashkengjiten;

***a**-kopja e vendimit qe duhet te zbatohet dhe perkthimi i tij ne gjuhen shqipe te noterizuar.*

***b**-vertetimin nga gjykata qe e ka nxjerre vendimin se ai ka marre forme te prere, si dhe perkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vertetimi se vendimi ka marre forme te prere, duhet te jene te vertetuara nga Ministria e puneve te jashtme e Republikes se Shqiperise.*

Ne nenin 399 te Koidt Procedures Civile parashikohet;

"Dispozitat e ketij kreu zabtohen edhe per njohjen e vendimit perfundimtar te nje arbitrazhi te huaj".

Gjykata e Arbitrazhit Nderkombetar gjate gjykimit te ceshtjes se pjesmarresve ne kete proces dhe marrjes se vendimeve te datave 16 12 2008 dhe 10.04.2009 ka zhvillur nje proces te rregullt gjyqesor ne kuptimin e nenit 6 pika 1 te Konventes Europiane te te drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut ne te cilen theksohet;

Cdo person ka te drejte qe ceshtja e tij te degjohet drejtesisht,publikisht dhe brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e

krijuar ligjerisht,e cila do te vendose qofte konfliktit mbi te drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil".

Midis paleve ne proces ka patur nje kontrate dhe me vullnetin e tyre te brendshem kane pranuar pikerisht arbitrazhin e Dhomes se Arbirave Nderkombetar ne Paris France (nen 9 i kontrates). Palet kane qene te pranishem dhe vec kesaj personi i trete KESH sha ka kerkuar dhe korrogjim dhe interpretim te vendimit, ku gjykata e Arbitrazhit eshte inevestuar perseri ne lidhje me kerkesen nga ku dale dhe shtojca e vendimit.

Ne vendin tone eshte ne fuqi ligji nr.8688 date 09.11.2000 ***"Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne konventen per njohjen e vendimeve te huaja dhe arbitrazhit".*** Po keshtu kemi aderuar ne Konventen Europiane te Arbitrazhit, konvente kjo e Gjeneves e dates 21.05.1961, aderimi i te ciles eshte bere me ligjin nr.8687 date 09.11.2000.

Pretendimi i avokates se shtetit "se *nuk eshte mbajtur procesverbal ne seance degjimore"* ndaj procesi eshte i parregullt, gjendet i pabazuar nga Gjykata e Apelit.

Ne kuptimin e parimit baze te ligjislacionit Shqiptar te parashikuar ne germen "dh" te nenit 394, eshte respektuar plotesisht parimi i kontradiktoritet i parashikuar ne nenin 18 te Kodit Procedures Civile i cili ka te sanksionuar:

"Asnje pale nuk mund te gjykohet pa u degjuar ose pa u thirrur ne gjykim ".

Ne rastin ne gjykim pala eshte thirrur eshte degjuar si dhe nga vete Arbitrazhi Nderkombetar eshte marre ne shqyrtim pretendimi i ngritur nga pala per procesverbalin ne seancen degjimore. Persa me siper nga ana e gjykates cmohet plotesisht e bazuar kerkesa e kerkuesit S4E Group GMBH per njohjen dhe dhenien fuqi te vendimit te Gjykates se Arbitrazit Nderkombetar, pasi nuk permban asnje nga pengesat ligjore te parashikuara ne nenin 394 te Kodit Procedures Civile dhe eshte plotesisht ne perputhje me ligjet e vendit dhe konventat nderkombetare ku vendi yne ka aderuar,si dhe gjykata e apelit ka pengese ligjore per te marre ne shqyrtim probleme te themelit te ceshtjes te ngritura nga perfaqesuaesja e Avokatures se Shtetit ne seance.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar ne nenin 395,396, 397 e 399 te K.Pr.Civile.

V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses.

-Te njohe dhe jape fuqi per zbatim ne Republiken e Shqiperise vendimit nr. 14939 te Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar Paris France per te gjitha detyrimet e percaktuara ne ate vendim te paleve ne proces.

Tiranë më datë 02.10.2014.

A N E T A R E	**A N E T A R**	**K R Y E S U E S**
Edmond GOGO	**Fatmira HAJDARI**	**Gramoz LEVANAJ**